



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.368/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR] nga Podujeva paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, ndërrimi i vendvotimit në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ZL.Anr.368/2025 e datës 04.11.2025, e parashtuar nga [REDAKTUAR] nga Podujeva, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, ndërrimi i vendvotimit në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.11.2025, [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin Dyz, komuna e Podujevës ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se si qytetar e Podujevës nuk gjindet në listën e votuesve si dhe i është ndërruar vendvotimi pa njoftim paraprak nga KQZ-ja dhe për këtë arsye nuk ka mundur të votoj .

Në përgjigje në ankesë, KQZ-ja sqaron se bazuar në nenin 8 paragrafi 1, dhe 2, nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, bëhet procesi i krijimit të Listës së Votuesve në Republikën e Kosovës.

Bazuar në dispozitat e mësipërme, KQZ njofton se Lista e votuesve përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe Qendrën e Votimit në të cilën votuesi është caktuar për të votuar. Përveç sqarimeve të lartcekura, KQZ shton se ka bërë vazhdimisht fushatë informuese, përmes mediave, rrjete sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin

e Qendrës së Votimit për votuesit e Republikës së Kosovës. Prandaj, pala ankuese është dashur që pretendimet e saj t'i paraqes gjatë periudhës dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar me datën 5 shtator 2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme

Në këtë rast, PZAP pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjes së dhenega KQZ- konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 03.11.2025, ku ka pretenduar se i është ndërruar qendra e vendvotimit, ndërsa sipas përgjigjes së dhene nga KQZ, pala ankuese është dashur që pretendimet e saj t'i paraqes gjatë periudhës dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar me datën 5 shtator 2025.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *“ Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara ”*.

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

PZAP konstaton se nga përgjigja e dhënë nga KQZ është vërtetuar se KQZ në vazhdimësi ka bërë fushatë informuese, përmes mediave, rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin e Qendrës Votimit për votuesit e R. Kosovës dhe qytetaret kanë pasur të drejtën e ndërrimit të vendvotimit deri me 29.08.2025. Ndërsa afati për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese ka përfunduar me datën 5 shtator 2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se certifikimi i listës përfundimtare të votuesve është bërë me datën 06 shtator 2025, që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, Nr. 2350-2025 është publikuar me datën 06.09.2025, dhe kundër këtij vendimi ka pasur afat ankese 48 orë nga marrja e vendimit.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati [REDAKTUAR] për shkak të ndërrimit të vendvotimit në ditën e zgjedhjeve, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e lartecekura, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën

paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.368/2025, datë 05.11.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.